

VENDIM
Nr. 153, datë 11.3.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për shpërblimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi fillojnë nga data 1 janar 2021 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

TABELA

Emërtesa e Bordit/Këshillit/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Nr. i anëtarëve	Kryetari	Anëtari
Këshilli i Emërimeve në Drejtësi	12	1	8	50,000	50,000
Komisioni për Licencimin e Ndërmjetësve	12	1	4	5,000	5,000
Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale	12	1	8	20,000	20,000
Komisionet e posaçme për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtarë të gjuhës përkatëse	5	1	4	10,000	10,000

Komisioni i posaçëm për provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave	5	1	4	10,000	10,000
Komisioni Disiplinor për Përkthyes Zyrtarë	5	1	4	15,000	10,000
Komisioni Disiplinor për Interpret të Gjuhës së Shenjave	5	1	4	15,000	10,000
Komisioni për Prodhimin Biologjik	12	1	8	8,000	6,000
Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët	12	1	4	10,000	10,000